



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Vendimi Nr.32/16
Prishtinë 24.10.2016

Në bazë të nenit 20, paragrafi (1),(2), neni 28, paragrafi (1.2) neni 35, paragrafi (2) , neni 54, paragrafi (1.3) , të Ligjit Për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229 (Gazeta zyrtare nr. 88/25), Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012, neni 20 paragrafi (1.3); duke vepruar sipas kërkesës për Vërtetim/Autorizim për Përqendrim të Lejuar nga Phoenix Pharma DOOEL Skopje, me adresë të regjistruar në Rr.Jadranska Magistrala nr.31 Skopje-Butel Maqedoni, përmes Zyrës së Avokaturës I.O.T, rr.Fehmi Agani 1/16,10010 Prishtinë me datë 10.12.2015, e përsëritur me datë 26.10.2016, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës me datën 28.10.2016, lëshon këtë:

V E N D I M

KONSIDEROHET I LEJUAR - Përqëndrimi ndërmjet Kompanisë Phoenix Pharma DOOEL Skopje, me adresë të regjistruar në Rr.Jadranska Magistrala nr.31 Skopje-Butel, Republika e Maqedonisë, e cila fiton kontrollin përmes blerjes së 100% të aksioneve mbi Exclusive Pharma Sh.p.k me seli në Zonën Industriale Nr.57 Prishtinë, Republika e Kosovës. Sipas vlerësimit të Autoritetit nuk përbën ndonjë shkelje, kufizim ose dëmtim të konkurrencës efektive në treg ose të një pjese të tij, duke pasur parasysh formimin apo forcimin e Pozitës Dominuese të pjesëmarrësve në Përqëndrim dhe si i tillë është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Autorizimi për Realizimin e Përqëndrimit i dhënë nga Komisioni në përputhje me nenin 20 paragrafi 2 të Ligjit Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 20 (1.3) të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2012 jepet kundrejt pagesës me vlerë 3.000,00 €, me shkronja (tre mijë euro).

Republika e Kosovës - Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
Adresa: RR. Zejnel Salihu PA# (ish objekti I gjykatës komunale). 10000, Prishtinë Kat i III, zyra Nr. B409/a
Tel: +381 /0/ 38 200 10 931 , 200 10 930 , 200 10 929



ARSYETIM

Autoriteti Kosovar për Mbrojtjen e Konkurrencës (në teksin e mëtuqjeshëm: Autoriteti), me datë: 02.11.2015 , ka pranuar Njoftimin e plote për përqendrim, i cili është rregjistruar si rast me numer 283/15-01,1/152, dhe kërkesen për Vërtetim për lejimin e përqendrimit dd: 10.12.2015 me numer 315/15-01, e përsëritur me date 26.10.2016 me numer 206/16-01/H.


Pjesëmarrësit në Përqendrim dhe aktiviteti i tyre


- Phoenix Pharma DOOEL Skopje me seli të rregjistruar në Rrugën Jadranska Magistrala Nr.31 Skopje – Butel Republika e Maqedonisë. Phoenix Pharma DOOEL është bërë anëtare e Phoenix Group më 2010-tën. Aktiviteti Biznesor: Tregtimi i produkteve farmaceutike. Gama e produkteve të Phoenix Pharma përfshinë : Distribuimi i produkteve farmaceutike për barnatoret dhe konsumatorin final,OTC - produktet dhe parafarmaci.
- Ekslusive Pharma Sh.p.k Zona Industriale Nr.57 Prishtinë Kosove, me Nr.Regjistrim 70946335, është anëtare e Ekslusive Group, e specializuar për distribuimin e produkteve medicinale dhe farmaceutike me aktivitetet biznesor : shitje me shumicë e produkteve farmaceutike.


Meqenëse parashtruesi ka dorëzuar Njoftimin për Përqendrim me 2 Nëntor 2015 deri më 03 Dhjetor 2015 dhe nga Autoriteti nuk është marrë Konkluzion për Fillimin e Procedurës për Vlerësimin e Përqendrimit, atëherë Përqendrimi konsiderohet se është i lejuar që nga data 3 Dhjetor 2015.


Duke pasur parasysh vlerësimin e këtyllë të përqendrimit Komisioni Vendosi ashtu siq parasheh dispozitivi i këtij Autorizimi.


KOMISIONI I AUTORITETI KOSOVAR TE KONKURENCËS


Ahmet Krasniqi
Zv. Kryetar


Fatime Haziri
Anëtare


Valon Prestreshi
Kryetar


Muhamed Krasniqi
Anëtar


Shaqir Morina
Anëtar

Republika e Kosovës - Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
Adresa: RR. Zejnel Salihu PA# (ish objekti I gjykatës komunale). 10000, Prishtinë Kati III, zyra Nr. B409/a
Tel: +381 /0/ 38 200 10 931 , 200 10 930 , 200 10 929

